

HISTORIKE: Nënshkruhet marrëveshja për formimin e Ligës Unike

Në Tiranë (10 shtator) është nënshkruar marrëveshja historike për formimin e Ligës Unike në basketboll mes Kosovës dhe Shqipërisë. Marrëveshjen e kanë nënshkruar, Presidenti i FSHB-së, Z. Avni Ponari dhe kryetari i FBK-së, Z. Arben Fetahu. Arben Fetahu ishte i lumtur që më në fund ky projekt madhor po finalizohet. "Jam shumë emocional në këtë ditë sikur kjo, ku po finalizojmë ligën unike të basketbollit. Dua të falënderoj të gjithë për përkrahjen që kanë treguar rreth kësaj lige që besoj se do të jetë shumë e veçantë dhe promotore e basketbollit shqiptar në përgjithësi. Prej ditës së parë kemi hasur në pengesa, por nuk jemi ndalur duke i tejkaluar të gjitha për ta krijuar këtë ligë që është e para mes Kosovës dhe Shqipërisë. Ky është moment historik dhe si sporti i parë që po e bëjmë këtë lëvizje shpresoj që të hapim dyert edhe për sportet tjera për një lëvizje të tillë", deklaroi Fetahu.

"Është një projekt, të cilin e kisha për zemër që nga dita e parë kur u zgjedha në krye te federatës dhe tani kjo liga e përbashkët ka marrë përkrahje nga të gjitha anët. Finalizimi i kësaj lige nuk ishte aspak i lehtë, por jam i bindur se liga unike do t'i bëjë bashkë të gjitha trojet shqiptare dhe promovuese për basketbollin shqiptar. Mendoj se kjo ligë do ta dërgoj basketbollin shqiptar drejt suksesit dhe jehonës", deklaroi Avni Ponari, president i FSHB-së. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama ka zbuluar logon dhe është shprehur se ky bashkëpunim duhet të thellohet edhe më shumë, dhe të mos ketë ndarje mes dy vendeve. "Krijimi i Ligës Unike i çon gjërat në nivel tjetër në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta. Kam shpresë dhe besim që kjo do të bëhet shtysë edhe për të tjerët. Aq për më tepër, në sport jemi të mëdhenj të jemi bashkë", u shpreh Rama.

Marrëveshjen e ka përshëndetur edhe Presidenti i FIBA Evropës, Turgay Demirel, duke ofruar përkrahjen për këtë ligë, por edhe për basketbollin e Kosovës dhe atë të Shqipërisë. Ai përgëzoi dy federatat për këtë iniciativë, sidomos në këtë kohë të pandemisë. "Basketbolli tani ka nevojë për risi dhe forma të reja të bashkëpunimit për të ngritur interesimin, por edhe nivelin e garave", deklaroi Demirel.

Në këtë ceremoni shumë të rëndësishme kanë marrë pjesë edhe Znj. Besa Shahini, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri dhe Znj. Vlora Dumoshi, Ministre për Kulturë, Rini dhe Sport e Kosovës. Vlora Dumoshi ishte e nderuar që ishte pjesë e kësaj marrëveshje historike. "Jam shumë e nderuar që jam pjesë e kësaj marrëveshjeje historike që po nënshkruhet mes Shqipërisë dhe Kosovës. Për mua ka qenë një befasi e këndshme dhe e mirëpritur. Me padurim kam pritur që kjo ligë është bërë realitet për qka falënderoj presidentët e federatave për realizimin e kësaj ëndrre të të gjithë shqiptarëve", nënvizoi Dumoshi.



Presidenti i FIBA Evropës, Demirel mori pjesë në ceremoninë e themelimit të ligës së përbashkët mes Shqipërisë dhe Kosovës

Presidenti i FIBA Evropës, Turgay Demirel vizitoi Tiranën ku mori pjesë në themelimin e ligës së përbashkët të basketbollit midis Federatës Shqiptare (FSHB) dhe Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), e cila shënon një hap të ri për zhvillimin e basketbollit në të dy vendet, shkruan faqja zyrtare e FIBA-s. Marrëveshja u nënshkrua nga Presidenti i FSHB-së, Z. Avni Ponari dhe Kryetari i FBK-së, Z. Arben Fetahu të enjten, në prani të Znj. Besa Shahini, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri dhe Znj. Vlora Dumoshi, Ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës. I pranishëm në ceremoni ishte edhe Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Z. Edi Rama, i cili zbuloi logon e Ligës Unike.

"Është kënaqësi e madhe të jem këtu në Tiranë për themelimin e ligës së re së bashku me mysafirë kaq të dalluar", tha Presidenti i FIBA Evropës, z. Demirel.

"Unë besoj se kjo iniciativë e përbashkët ka premtime të mëdha dhe jo vetëm që do të vendosë një standard të ri për basketbollin e klubeve në Shqipëri dhe Kosovë, por gjithashtu do të përfitojnë edhe ekipet kombëtare të të dy vendeve. Është gjithmonë ndjenjë e mirë të shohësh federatat tona kombëtare duke punuar krah për krah për të mirën e lojës, veçanërisht me projekte të tilla ambicioze si Liga Unike. Unë dua të përgëzoj të dy kryetarët, Z. Ponari dhe Z. Fetahu, si dhe ekipet e tyre, për punën e madhe që kanë bërë për ta sjellë këtë ide në jetë".



Zgjedhen anëtarët dhe kryetari i Bordit të Ligës Unike

Të enjten në zyret e Federatës së Basketbollit të Shqipërisë (FSHB) në Tiranë, është mbajtur takimi i parë i Bordit Drejtues të Ligës Unike. Anëtarë të Bordit Drejtues të Ligës Unike janë: Elvira Dushku, Shaqir Totaj, Edmond Biqoku, Korab Llazani, derisa kryetar është zgjedhur Ilir Trebicka, një emër i njohur që ka dhënë shumë kontribut në basketbollin shqiptar apo edhe ikonë e basketbollit shqiptar.

Bordi më pas e emëroi drejtorin e Ligës, Dren Zatriqin, kurse Sekretar Teknik është zgjedhur Fidan Hamiti. Ndërkohë, Zyrtari i Marketingut do të jetë Dren Hasangjekaj, kurse Zyrtare e Financave, Nadire Kajashi.

Në këtë takim u zotuan se do të punojnë që kjo ligë të jetë sa më e suksesshme dhe interesante për publikun, klubet dhe adhuruesit e basketbollit. Takimi i radhës i Bordit do të mbahet në Prishtinë, ku do të diskutohet për detaje tjera të Ligës Unike.

Liga Unike në sytë e basketbollistëve të Kosovës, trajnerëve e analistëve

Më shtator u nënshkrua zyrtarisht formimi i Ligës Unike mes Kosovës dhe Shqipërisë. Marrëveshjen e nënshkruan Presidenti i FSHB-së, Avni Ponari dhe Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu. Liga do të ketë tetë skuadra, katër më të mirat nga Kosova dhe katër më të mirat nga Shqipëria.

Ideja e formimit të kësaj lige është mirëpritur në Kosovë e Shqipëri nga analistët, klubet dhe basketbollistët, që kanë folur për faqen zyrtare të FBK-së.

Masar Nixha, Mithat Belegu, Ferit Zekolli, Valentin Spaqi, Artan Mehmeti, Dardan Berisha, Edmond Azemi, Drilon Hajrizi, Samir Zekiqi, Valon Bunjaku, Bardh Rexha, Gerti Shima, Endrit Hysenagolli u shprehën se e përkrahën këtë ide.

Përfaqësuesja A e Femrave do të marrë pjesë në garat zyrtare të FIBA-s

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) ka marrë vendim (më 9 korrik) për paraqitjen e Përfaqësueses A të Femrave në garat zyrtare të FIBA-s, më saktësisht në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla, që do të organizohet në vitin e ardhshëm në Nicosia të Qipros prej 15 deri më 20 Qershor. Vendimi është marrë pasi është diskutuar më parë në Bord dhe pas analizave të bëra për Përfaqësueset e Kosovës në konkurrencën e femrave ndërmjet Kryetarit të FBK-së, Arben Fetahu, Sekretares së Përgjithshme, Elvira Dushku dhe Drejtorit të Përfaqësuesëve, Granit Rugova.



Përkrahët ideja e formimit të Përfaqësueses A të femrat

Në Kosovë është përkrahur ideja që të formohet Përfaqësuesja A e femrave dhe të garojë në arenën ndërkombëtare.

Christos Marmarinos, Resmije Juniku, Teuta Abdullahu, Vlora Braha, Valbona Bytyqi, Saranda Daci, Arbnore Perquku, Irma Konjusha, Dea Pushkollli, Astera Tuhina, Enisa Kamerolli u shprehën për faqen zyrtare të FBK-së se e përkrahin këtë ide dhe shpresojnë se Kosova A e femrave do të ketë sa më shumë suksese në arenën ndërkombëtare.

“Presim mbështetje nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, por edhe sponsorët e ndryshëm, pasi kemi nevojë për përkrahje, që të kemi një përfaqësim sa më të mirë në garat ndërkombëtare. Besoj se, do të kemi përkrahje edhe nga komuniteti i basketbollit, për shkak se, do të debutojmë zyrtarisht në arenën ndërkombëtare dhe ky është një hap i madh për basketbollin e femrave në Kosovë”, u shpreh ndër të tjera Elvira Dushku, Sekretare e Përgjithshme e FBK-së.

FIBA: Aстера Tuhina në mesin e super-talenteve të Evropës

“Driblim me dorën e majtë, pastaj me të djathtë, shënim për dy pikë me tabelë, gjuajtje mjaft precize për tre pikë, vizion dhe gjallëri të mrekullueshme në parket që çdoherë të sjellë buzëqeshje në fytyrë kur e shikon duke luajtur, Tuhina i ngërthen të gjitha në një dhe është kënaqësi e madhe për ta parë. Ajo është edhe mjaft e guximshme dhe vitin e kaluar kur mori pjesë në FIBA Kampionatin Evropian U20 për Femra dhe luajti kundër lojtarëve që ishin 4-5 vjet më të mëdha në moshë, me mjaft meritë pati vlerësime të shkëlqyeshme. Ajo është shpresa e madhe e Kosovës, si një nga shtetet më të reja të basketbollit që mundohet të fitojë një vend në hartën sportive”.

Ky është përshkrimi që ia ka bërë Paul Nilsen (i pasionuar pas promovimit të basketbollit të femrave) në faqen zyrtare të FIBA-s në artikullin që i dedikohet grupmoshës U16 të vajzave, më 7 gusht.

“Anulimi i FIBA Kampionateve Evropiane të të Rinjve për shkak të pandemisë Covid-19 i ka goditur të gjithë, por ka diçka veçanërisht pikëlluese për humbjen e edicionit të vitit 2020 të FIBA U16 Kampionateve Evropiane. Si tifoz i flaktë i basketbollit të të rinjve dhe pasi kam dashur shumë të shoh yje të shumtë duke shkëlqyer në këtë garë (qoftë Divizion A apo B) unë jam i vetëdijshëm se kjo nuk do të ndodhë. Atëherë, cilat janë lojtarët që unë kam pritur me padurim ti shoh nëse Covid-19 të mos ndodhte”, ka shkruar Nilsen në artikullin e publikuar në faqen zyrtare të FIBA-s.



Bordi i FIBA Evropës vendos që Evropiani i Divizionit C të mbahet në Prishtinë

Bordi i FIBA Evropës ka dhënë dritën e gjelbër (2 shtator) për mbajtjen e Kampionatit Evropian, Divizioni C, për meshkuj U16 më 2021 në Prishtinë. Ky kampionat është dashur që të mbahet këtë vit, megjithatë, për shkak të pandemisë me Covid-19, të gjitha Kampionatet Evropiane për grupmosha të reja ishin shtyrë. Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) kishte aplikuar sërish që Evropiani i vitit të ardhshëm të mbahet në Prishtinë dhe ka marrë miratimin nga Bordi i FIBA Evropës. Kështu, Kampionati Evropian për Divizionin C për meshkuj U16 do të mbahet në Prishtinë nga 10 deri më 18 korrik më 2021. FIBA i beson kështu Kosovës edhe një organizim të rëndësishëm, pasi në vitin 2018 kishte organizuar me sukses Kampionatin Evropian, Divizioni C për meshkuj U18 dhe në vitin 2019 dhe Kampionatin Evropian, Divizioni B për femra U20.



Drejtuesit e FBK-së do të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Evropës

Asambleja e Përgjithshme e FIBA Evropës do të mbahet më 9 tetor, derisa kësaj radhe do të jetë 'online' për shkak të situatës me pandeminë Covid-19. Në këtë Asamble do të marrin pjesë edhe kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku, duke përfaqësuar Kosovën në këtë ngjarje shumë të rëndësishme. Situata në lidhje me Covid-19, pritet të jetë një nga temat e diskutimit, që ka ndikuar në operacionet e basketbollit në Evropë, veçanërisht në një nivel ndërkombëtar. Asambleja ishte dashur të zhvillohej në Lituani, megjithatë, do të mbahet në formë të videokonferencës. Të gjitha detajet mbi Asamblenë e Përgjithshme do t'i komunikohen Federatave Kombëtare në kohën e duhur.

Arben Krasniqi emërohet Drejtor Teknik në Federatën e Basketbollit të Kosovës

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) më 17.09.2020 e ka emëruar Arben Krasniqin në pozitën e Drejtorit Teknik (Drejtor i Programeve të Basketbollit) në Federatën e Basketbollit të Kosovës. Përgjegjësitë Kryesore të Drejtorit Teknik të FBK-së do të jenë: Të menaxhoj Programin Nacional të Certifikimit të Trajnerëve për FBK dhe SHTBK; Të zhvilloj dhe menaxhoj programin e trajnimit të trajnerëve të FBK-së; Të menaxhoj Qendrën Nationale të Basketbollit dhe Akademitë e Basketbollit të krijuara në kuadër të kësaj qendre; Të koordinoj dhe menaxhoj të gjitha aktivitetet e shkollave dhe Universiteteve për FBK-në; Të koordinoj dhe menaxhoj Kampin Nacional të FBK-së për gjeneratat e reja. Ndërkaq Drejtori Teknik i FBK-së do të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e pjesëmarrjes dhe të gjitha programeve të FBK-së, si dhe shërbimeve me përgjegjësi në fushën e: Zhvillimit të trajnerëve; Zhvillimit të lojtarëve; Qendrën Nationale të Basketbollit; Zhvillimin e Akademive të Basketbollit; Masivizimin dhe promovimin e Mini-Basketbollit në të gjitha regjionet e Kosovës.



FBK në bashkëpunim me FIBA-n vazhdojnë punën intensive në hartimin e Planit Strategjik

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) në bashkëpunim me FIBA-n është duke punuar intensivisht në përgatitjen e hartimit të Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025.

Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku dhe Drejtori i Përfaqësueseve të Kosovës, Granit Rugova të premten (18 korrik) e kanë zhvilluar takimin e radhës të punës (online) me ekspertët e FIBA-s të cilët janë të angazhuar për të mbështetur FBK-në në hartimin e planit strategjik. Vetëm gjatë tri javëve të fundit FBK në bashkëpunim me FIBA-n kanë përgatitur anketa me të gjitha grupet e interesit të FBK-së, pastaj intervista me zyrtarë të lartë të FBK-së, me zyrtarë të lartë të sportit në vendin tonë, me anëtarë të Bordit të FBK-së, me stafin e zyrës ekzekutive të FBK-së, si dhe takime të punës me Kryetarin dhe Sekretaren e Përgjithshme të FBK-së. Dhe e tërë kjo punë është bërë në mënyrë që e gjithë familja e basketbollit në vendin tonë të jetë pjesë e hartimit të këtij plani strategjik.

FIBA mbështet FBK-në për vitin e tretë radhazi nëpërmjet projektit FIBA Europe Girls' Basketball Program

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) së fundi (30 korrik) është informuar zyrtarisht nga FIBA se kjo e fundit e ka aprovuar aplikacionin e FBK-së për projekt-propozimin e përgatitur nga FBK për FIBA Europe Girls' Basketball Program, pjesë e të cilit është edhe kampanja "Her World, Her Rules" (Bota e Saj, Rregullat e Saj). Ky është viti i tretë radhazi që FBK është fituese e këtij projekti në FIBA. Në fakt pas përfundimit me sukses të projektit të vitit 2019, FBK është dashur të mbyll projektin, pra në një raport të punës dhe financiar të detajuar dhe më pas të ketë të drejtë të aplikojë për projektin e ri, gjë që FBK e ka bërë dhe Komiteti i Menaxhimit të Projekteve në FIBA e ka vlerësuar aplikacionin e FBK-së si të suksesshëm. FIBA në vitin 2018 e ka lansuar një program të ri për vajza nëpërmjet të cilit synon që të promovojë sa më shumë basketbollin në konkurrencën e femrave në Evropë, duke i tërhequr kështu vajzat e moshës 6 deri në 14 vjeç për të praktikuar basketbollin nëpërmjet kampanjës së ashtuquajtur "Her World, Her Rules".

Federatat dhe klubet kërkojnë ndihmë, Dumoshi lavdëron FBK-në për krijimin e Ligës Unike

Në Prishtinë ka filluar Java Evropiane e Sportit (23 shtator), që do të zgjasë deri më 30 shtator. Në ditën e parë, organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe Komitetit Olimpik i Kosovës (KOK) është organizuar "Forumi për Sportin". Në këtë aktivitet kanë marrë Vlora Dumoshi, ministre e MKRS, Armend Zemaj, ministër i Shëndetësitë, Besim Hasani, kryetar i KOK-ut, si dhe përfaqësues tjerë nga federatat sportive, por edhe të Departamentit të Sportit, derisa Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK) e përfaqësuan kryetari Arben Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku. Në temën "Sporti dhe Covid-19", është folur për ndihmën që kanë nevojë federatat dhe klubet sportive.

"Pakoja emergjente e ndarë nga Qeveria Hoti do të dedikohet për klubet, pasi jemi të vetëdijshëm që bizneset nuk kanë mundur të ndihmojnë klubet gjatë pandemisë. Do të bisedojmë bashkë me kryetarin e KOK-ut, Besim Hasani dhe federatat sportive, për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së tyre. Ligji për Pakon Emergjente është dërguar tri herë në Kuvendin e Kosovës, por nuk është miratuar nga Deputetët. Sigurisht se kur të miratohet do të ndihmojmë federatat dhe klubet", u shpreh ministrja për Kulturë, Rini e Sport, Vlora Dumoshi, gjatë pjesëmarrjes në "Forum e Sportit", që hapi Javën Evropiane të Sportit. Ajo kishte edhe një falënderim në këtë Forum. "Falënderoj Federatën e Basketbollit, që së bashku me Federatën Shqiptare të Basketbollit kanë formuar Ligën Unike. Këso iniciativa duhet të ndërmarrin edhe federatat tjera, sidomos në këtë kohë të pandemisë, kur ka më pak aktivitete sportive", shtoi tutje Dumoshi, e cila kërkoj që të ndihmohen më shumë edhe klubet e femrave.



Fetahu flet për Planin Strategjik në Basketboll dhe punën që po e bën FBK-ja

Në Konferencën "Forumi për Sportin" në kuadër të aktivitetit të Javës Evropiane të Sportit, tema e dytë e panelistëve ka qenë Strategjia Kombëtare për Sportin, Qeverisja e Mirë dhe Barazia Gjinore.

Në këtë panel ka folur edhe kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu. "FBK-ja ka filluar në hartimin e Planit Strategjik në Basketboll, ku puna ka nisur në muajin prill dhe do të vazhdoj deri në fund të vitit, kjo edhe për shkak të situatës me pandeminë. Është keq që nuk ka pasur Strategji Kombëtare të Sportit më herët, por kjo është një mundësi që Federatat Sportive ta bëjnë secila dhe më pas kjo të merret parasysh edhe nga Ministria e Sportit. Plani Strategjik i yni është deri në vitin 2025 dhe nuk jemi fokusuar vetëm për një vit ose katër. Megjithatë, ky Plan do të kalojë në një proces, ku do të shikohet nga Grupi Punues, pastaj do të shkon për miratim në Bordin e FBK-së dhe më pas në Kuvendin e FBK-së. Ne jemi të interesuar për avancimin e femrave në basketboll, por gjithashtu edhe në masivizim, si dhe të ngritim cilësinë. Sa i përket barazisë gjinore, ne si FBK-ja gjithmonë jemi munduar tu japim të drejtë femrave, si në stafin e FBK-së, po ashtu në përgjithësi në basketbollin e Kosovës", u shpreh Fetahu para të pranishëmve.

Pikërisht për Barazinë Gjinore ka folur Afërdita Fazlija, zëvendës drejtoreshë e Departamentit të Sportit. "Situata në sportin e femrave në Kosovë nuk është aspak e mirë. Shembull është edhe fitorja me Estoninë, ku edhe pse jemi përgëzuar të premtën, por shumë shpejt është harruar dhe nuk është përmendur aq sa e meritojnë vashat

e Kosovës, sidomos nga mediat në vendin tonë. Është morale, njerëzore, por edhe me kushtetutë që të respektohen femrat. Sa i përket rezultateve, femrat sportiste kanë pasur shumë rezultate pozitive kulminante, por e them në mënyrë gjenerale, situata nuk është e mirë. Shembull për këtë është edhe shuarja e nënkampionit të Kosovës në futboll. Mendoj se nga Pako Emergjente duhet të ndihmohen më shumë klubet e femrave, pasi janë në një situatë të rëndë”, deklaroi ndër të tjera Fazlija.

Pjesë e panelit ishin edhe Shasivar Haxhija, Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Kosovës, Fitim Arifi, u.d. i Departamentit të Sportit të Kosovës, Naim Muja kryetar i Federatës së Mundjes dhe Valon Nikqi, Sekretar i Përgjithshëm i Federatës së Volejbollit të Kosovës.



Deklaratë e FIBA-s në lidhje me ndeshjet e Nëntorit 2020 dhe Shkurtit 2021

Duke pasur parasysh shëndetin dhe sigurinë e lojtarëve, trajnerëve dhe stafit në vend të parë, dhe pas një rekomandimi nga Komisioni Mjekësor dhe Komisioni i Garave, Komiteti Ekzekutiv i FIBA-s ka vendosur (18 shtator) në lidhje me Kualifikuesit e Nëntorit 2020 dhe Shkurtit 2021 për Kupat Kontinentale si më poshtë:

Të gjitha ndeshjet e të dy dritareve duhet të zhvillohen në një "kompleks", ku do të izoloohen në një vend nga pjesa tjetër e popullësisë, në vend të vendas/mysafirë, me marrëveshjen e autoriteteve të shëndetit publik pritës dhe në përputhje me protokollat shëndetësore të FIBA (përfshirë testimin e PCR dhe hyrjen e kontrolluar në një mjedis të sigurt në qytetin pritës);

Çdo "kompleks" do të përbëhet nga 4 ose 8 ekipe (një ose dy grupe kualifikimi). Pritësit do të vendosen në nivelin rajonal dhe do të shpallen në kohën e duhur.

FIBA do të vazhdojë të monitorojë situatën COVID-19 në baza ditore dhe të komunikojë azhurnime të mëtejshme në lidhje me Garat e FIBA-s kur është e nevojshme.

Në Raundin e Parë të para-kualifikimeve për FIBA Kupën e Botës 2023. Kosova është në Grupin B, së bashku me Islandën, Sllovakinë dhe Luksemburgun.

Përmbillet Java Evropiane e Sportit me aktivitetin në lojën 3x3

Sonte (30 shtator) është mbyllur edhe zyrtarisht Java Evropiane e Sportit #BEACTIVE me aktivitetin në 3x3, që u mbajt në Prishtinë, në lagjen Dardania, derisa aktivitet i ngjashëm ishte mbajtur edhe në Prizren. Këto aktivitete janë organizuar nga Federata e Basketbollit të Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Turneu në Prishtinë ishte shumë mirë i organizuar, ku morën pjesë Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, Kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, Fitim Rexha, Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Prishtinës, përfaqësues nga Ministria e Sportit, Departamentit të Sportit dhe Komunës së Prishtinës dhe personalitete nga basketbolli. Këtë aktivitet e ka përkrahur edhe zëvendësdrojtresha e Departamentit të Sportit, Afërdita Fazlija.

Si në Prizren, ashtu edhe në Prishtinë, morën pjesë shumë skuadra në të dy konkurrencat nën moshën 15-vjeçare. Sidoqoftë, qëllimi i turneut nuk ishte garues, por që të rinjtë të merren më shumë me sport dhe të jenë sa më aktivë. Dumoshi në fjalën përmbyllëse është shprehur se, është e lumtur që po merr pjesë në këtë ngjarje dhe që Java Evropiane e Sportit, ku kishte shumë ngjarje sportive, po përmbyllet me një aktivitet shumë të rëndësishëm, siç ishte kjo në 3x3.

Ajo u ka bërë thirrje fëmijëve të merren me sport, derisa është zotuar se do të investojë më shumë në infrastrukturë, pasi sukseset më të mëdha Kosova i ka në sport.

Para fjalimit të saj është zhvilluar edhe një lojë relaksuese mes zyrtarëve të FBK-së, MKRS-së, Departamentit të Sportit dhe Komunës së Prishtinës, duke fituar duartrokitjet e të pranishmëve. Java Evropiane e Sportit u zhvillua nga 23 deri më 30 shtator.



Mbahet aktiviteti "Her World, Her Rules"

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka vazhduar me zhvillimin e kampanjës "Her World, Her Rules". Aktiviteti është mbajtur më 11 korrik në fushën e basketbollit në Marigona Rezidencë. Aktiviteti është mbajtur në ambient të hapur, derisa është respektuar edhe distanca fizike, si dhe higjiena, që janë shumë të rëndësishme në këtë kohë. "Her World, Her Rules" është një projekt unik dhe fushatë në mediat sociale, e udhëhequr nga FIBA Europe që ka për qëllim të promovojë basketbollin e femrave dhe vajzave nëpër Evropë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme që realizohen në partneritet me Federatat Nacionale.



Shumë spektakël në organizimin e '3x3 Prishtina'

3x3 Prishtina, njëra nga ngjarjet më atraktive në Prishtinë është mbajtur të dielën (7 shtator), ngjarje e cila u mbajt për herë të tretë me radhë në qytetin e Prishtinës. 3x3Prishtina, ngjarje kjo e cila bashkoi Streetball-in me Hip-Hop, dje bashkoi shumë sportistë dhe adhurues të sportit të basketbollit dhe shumë personazhe publike. Ky aktivitet është përkrahur edhe nga Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK), duke i ndihmuar me pajisje, fusha, topa, gjyqtarë, etj. Pjesëmarrës ishin 10 ekipe ku morën pjesë ekipet nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia Veriore. Ekipi fitues ishte 'The Answer' nga Shkodra, që arritën në finale kundër skuadrës 'Alfa L' nga Istogu. Ngjarja ofroi shumë atraksione dhe dinamika të ndryshme përmes 'Dunk Challenge' të cilën e fitoi Kujtim Ujkani, 'Three-Point Challenge' të cilën e fitoi Alban Latifaj, si dhe performanca nga Lumi B për audiencën prezente.

Kësaj radhe, 3x3 Prishtina International Satellite Tournament, e lincensuar nga FIBA 3x3, u mbajt me numër të limituar të shikuesve shkak i situatës së krijuar nga Covid-19, duke marrë masa për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve.

Drejtuesit e FBK-së bisedojnë me përfaqësuesit e klubeve, diskutojnë për gjendjen aktuale dhe sezonin e ri

Drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) kanë pasur një bisedë (12 korrik) me përfaqësuesit e klubeve të Superligës së Kosovës në basketboll. Në këtë takim kanë marrë pjesë, kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe drejtori i Përfaqësuesëve të Kosovës, Granit Rugova, shumica e klubeve të Superligës, si dhe FIBA Instruktori Nacional i FBK-së, Faton Kurshumlija. Drejtuesit e FBK-së kanë shprehur gatishmërinë e plotë për tu ndihmuar klubeve në këtë situatë aspak të lehtë për basketbollin e Kosovës dhe që ato të rikthehen sa më shpejt për edicionin e ri. Gjithashtu në këtë takim është biseduar për fillimin e edicionit të ri, kalendarit të garave, Superkupës, që pritet të organizohet para fillimit të garave të Superligës. Përfaqësuesit e Klubeve kanë treguar për problemet që ballafaqohen dhe kanë bashkëbiseduar se si do të jetë edicioni i ardhshëm i garave. Klubet janë pajtuar për ndryshimet që do të bëhen në garat e edicionit të ri dhe shpresojnë të kenë një stinor sa më të mirë për basketbollin e Kosovës. FBK-ja do të vazhdojë të ndihmojë klubet në çfarëdo forme që është e mundur të kalojnë këtë gjendje dhe të përgatiten për edicionin e ri.

Udhëheqësit e FBK-së takohen me Shoqatën e Trajnerëve të Basketbollit

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu dhe Drejtori i Përfaqësuesëve të Kosovës, Granit Rugova, të hënën (13 korrik) në zyrat e FBK-së janë takuar me drejtuesit e Shoqatës së Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës. Zyrtarët e FBK-së kanë dhënë mbështetjen e tyre për Shoqatën e Trajnerëve, derisa në këtë takim është biseduar për përgatitjet për sistem të edukimit formal të FIBA-s, me përkrahje nga shtëpia e basketbollit botëror. Kjo është përkrahje e radhës nga FIBA për sistemin e licencimit dhe edukimit të trajnerëve. Edukimi i trajnerëve dhe licencimi i tyre është shumë i rëndësishëm për Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe këtë e ka potencuar në takim edhe i pari i basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu. FBK-ja në vitet e fundit ka mbajtur shumë seminare me trajnerë, njëkohësisht edhe disa trajnerë vendorë janë shkolluar në programet e FIBA-s.

Takim i frytshëm mes drejtuesve të FBK-së dhe KOK-ut

Me ftesë të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj, janë pritur sot (15 shtator) nga krerët e FBK-së, kryetari Arben Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme, Elvira Dushku. Presidenti Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Haxhijaj, përgëzuan FBK-në, për nënshkrimin e marrëveshjes historike me Federatën e Basketbollit të Shqipërisë, për krijimin e një Lige Unike, duke e cilësuar si lajm pozitiv, i cili erdhi në kohën dhe momentin e duhur. I pari i basketbollit në vend, Fetahu, duke falënderuar drejtuesit e KOK-un për takimin,

shpalosi detaje të organizimit të kësaj Lige, për të cilën shprehu besimin se do të ketë efektin pozitiv dhe se shembulline tyre mund ta ndjekine dhe federata tjera. Të dyja palët diskutuan për projektet më të reja, si dhe format më të mira të bashkëpunimit mes dy institucioneve, bashkëpunim ky i cili nuk ka munguar as në të kaluarën. Dëmet e shkaktuara në sportin kosovar, me theks të veçantë basketbollin, ishte njëra nga temat e diskutuara, për çka të dyja palët u pajtuan se dëmet janë të pariparueshme. Të dyja palët shkëmbyen edhe dhurata modeste.



Basketbolli përballë pandemisë, krerët e FBK-së kërkojnë përkrahje nga Ministria e Sportit

Krerët e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), kryetari Arben Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku e kanë pasur një javë të ngjeshur sa i përket takimeve me zyrtarë të lartë të sportit, ku janë diskutuar tema nga më të ndryshmet e që lidhen me sportin përballë pandemisë, më saktësisht basketbollin përballë pandemisë.

Së fundi (21 gusht) Kryetari Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme Dushku janë pritur në një takim pune nga Ministrja për Kulturë, Rini dhe Sport, Vlora Dumoshi, si dhe nga u.d. Sekretari i Përgjithshëm i MKRS-së, Ibër Alaj. Tri, kanë qenë temat kryesore që janë ngritur si çështje më urgjente nga numri një i FBK-së, Fetahu e ato janë: ndihma nga pakoja emergjente e Qeverisë për klubet tona, për basketbollistët/et, fillimi i garave të basketbollit dhe themelimi i Ligës Unike të Basketbollit.

"Ministrja Dumoshi e kuptoi mjaft mirë situatën e FBK-së karshi klubeve dhe basketbollistëve/eve dhe premtoi se në një kohë shumë të shkurtër do të formohet një grup punues për të çuar procesin përpara. Ne jemi shumë të kënaqur me bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me MKRS-në si institucion, pastaj edhe me vetë Ministren Dumoshi dhe u.d. Sekretarin e Përgjithshëm Alaj dhe i jemi mirënjohës pafund për mbështjen e pazezervë të MKRS-së dhe DSK-së ndaj projekteve të Federatës duke përfshirë ato të basketbollit dhe basketbollit 3x3", u shpreh ndër të tjera Kryetari i FBK-së.



Hidhet shorti i Superligës, derbi i vjetër në xhiron e parë

Sot (11 shtator), në zyrat e Federatës së Basketbollit të Kosovës është bërë hedhja e shortit për edicionin 2020-2021 në Superligën e Kosovës në basketboll. Edicioni i ri do të fillojë më 21 tetor, kur edhe do të zhvillohet xhiroja e parë. Ndërkohë, para fillimi të edicionit të ri në elitën e basketbollit do të zhvillohen ndeshjet e "Play-out"-it ndërmjet Trepçës dhe AS Prishtinës, ku fituesi do të garojë në Superligë. Që në javën e parë do të kemi derbin ndërmjet rivalëve të vjetër, Pejës dhe Sigal Prishtinës. Në takimet tjera, Rahoveci e pret Vëllaznimin që ka hyrë si fituese e Ligës së Parë, derisa Golden Eagle Ylli do të ballafaqohet me Ponte Prizrenin. Bashkimi do të ndeshet me Trepça/AS Prishtina.



Përfundon afati, këto janë klubet e regjistruara për edicionin e ri

Ka përfunduar afati për paraqitjen e klubeve për edicionin e ri 2020/2021 në basketboll. Edicioni i ri do të nisë në mesin e muajit tetor me ndeshjet e Superkupës për të vazhduar më pas me takimet e Superligës. Në sezonin e ri në Superligë do të garojnë tetë skuadra, kurse për një vend në "play-out" do të garojnë Trepça dhe AS Prishtina.

Klubet e regjistruar për Superligë janë: Sigal Prishtina, Peja, Bashkimi, Ponte Prizreni, Golden Egale Ylli, Rahoveci, Trepça, Vëllaznimi.

Ndërkohë, për Ligën e Parë janë paraqitur: Lipjani, Marigona Hill Prishtina, Istogu, AS Prishtina, Prishtina e Re, Vushtrria, Drita, Mega Sport dhe New Basket.

Në Ligën e Dytë janë paraqitur këto skuadra: Dardanët, Dukagjini, Llapi, Borea, Gjakova, Sfera, United Basketball, Gjakova e Re, Kaçaniku dhe Fushë Kosova.

Për Superligën e Femrave janë paraqitur: Bashkimi, Kosovahome Prishtina, Penza, Trepça, Vëllaznimi, Kastrioti.

Për Ligën e Parë të Femrave janë paraqitur: Kerasan Prishtina, Drita, United Basketball, Kaçaniku, Sfera, Vushtrria, Junior 06 dhe Istogu.

Lejohen aktivitetet sportive në hapësira të mbyllura

Qeveria e Kosovës ka marrë vendim (26 shtator) që të lejohen aktivitetet sportive në hapësira të mbyllura. Ky vendim lejon klubet që të stërviten në palestra, derisa fillimi i stinorit të ri në basketbollin e Kosovës është planifikuar më 14 tetor, me ndeshjet e Superkupës, për të vazhduar më pas me garat në elitë dhe ligat tjera. "Lejohen aktivitetet sportive në hapësira të mbyllura dhe të hapura; stërvitjet dhe garat mund të organizohen në sportet individuale; në hapësirat e mbyllura, gjatë stërvitjeve mund të marrin pjesë deri në 30 persona, ndërsa në organizimin e garave mund të marrin pjesë deri në 50 persona, gjithmonë duke u bazuar në Manualin për mbrojtjen nga përhapja e COVID19. Matja e temperaturës është e detyrueshme gjatë hyrjeve në objekte të mbyllura sportive si dhe në hapësirat e hapura sportive", thuhet në vendimin e Qeverisë së Kosovës. Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) ju bën thirrje klubeve, trajnerëve e lojtarëve të respektojnë masat nga Qeveria e Kosovës. Njëkohësisht FBK-ja ka përgatitur Deklaratën që duhet të nënshkruajnë akterët në basketboll para fillimit të garave, ku zotohen se do t'i respektojnë masat.



FBK dhe SHTBK në koordinim me FIBA-n e kanë publikur Udhëzuesin e Trajnerëve – Niveli 1 në gjuhën shqipe

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës (SHTBK), në koordinim me Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA) e kanë publikuar (13 gusht) në gjuhën shqipe Udhëzuesin i Nivelit 1 i Asociacionit Botëror të Trajnerëve të Basketbollit (WABC). Ky Udhëzues, që në fakt përbën material trajnimi dhe certifikimi themelor të FIBA-s për të gjithë trajnerët e basketbollit, trajton të gjitha sferat kryesore të sportit të basketbollit, përfshirë, mes tjerash, shkathtësitë e basketbollit në mbrojtje dhe sulm, përgatitja fizike, roli dhe vlerat e trajnerit për zhvillim, menaxhim dhe udhëheqje të skuadrës, si dhe taktikat e strategjitë dhe analiza e lojës së basketbollit. Përkthimi, shqipërimi dhe përshtatja në shqip e këtij publikimi është financuar nga FIBA dhe është realizuar nga trajneri i mirënjohur kosovar, Arben Krasniqi, ndërsa publikimi dhe shtypi i tij është financuar nga Departamenti i Sporteve të Kosovës (DSK) dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), duke rikonfirmuar sërish përkrahjen institucionale për zhvillimin e basketbollit dhe avancimin dhe institucionalizimin e zejës së trajnerëve të basketbollit në Kosovë dhe duke hapur rrugë procesit të trajnimit formal dhe licencimit të trajnerëve në vendin tonë.

Seminar i suksesshëm me trajnerë të njohur

Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës (SHTBK) në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK) gjatë fundjavës (26-27 shtator) ka organizuar seminarin me trajnerë të njohur. Në këtë seminar Online, kanë ligjëruar Don Showalter, Drejtor i zhvillimit të basketbollistëve të rinj pranë 'USA BASKETBALL', Mike Kelly, Trajner i Cairns Taipans (Australi)-trajneri i vitit 2020 në Australi, Cody Toppert, Ndhimëstrajner në Universitetin e Memphisit dhe Roberto Iezzi, Trajner kondicional i Hapoel Jerusalem. Albert Sylejmani nga SHTBK ka thënë se ky ishte një ndër seminarët më të mirë, që është organizuar në vitet e fundit. Sylejmani shtoi se trajnerët kanë ndarë përvojat e tyre me trajnerët e Kosovës. Ky seminar u mbajt për dy ditë, ku për shkak të Covid-19 është mbajtur Online, derisa kanë marrë pjesë 56 trajnerë të Kosovës. Sylejmani nënvizoi se për trajnerët që nuk kanë marrë pjesë do të ketë masa ndëshkuese nga Bordi i SHTBK-së. Trajnerët pjesëmarrës janë ndarë të kënaqur shumë me seminarin nga Shoqata dhe FBK

Mbahet Kampi i Gjyqtarëve Fillestarë

Më 4 dhe 5 korrik në sallën e sporteve të Fakultetit të Shkencave Sportive në Prishtinë është mbajtur Kampi i Gjyqtarëve Fillestarë, të cilët do të licencohen para fillimit të edicionit 2020-2021 dhe do të jenë pjesë e nominimit në ndeshjet e kategorive të reja. Pjesëmarrës kanë qenë 10 gjyqtarë, si dhe pesë gjyqtarë nga SHGJFBK-ja kanë asistuar në punën e FIBA Instruktorit Nacional të Gjyqtarëve. Të gjithë pjesëmarrësit kanë respektuar distancën dhe rekomandimet e nevojshme, kurse FBK-ja ka siguruar mjetet higjienike si dhe një shujtë (drekë) ushqimore. Gjyqtarët pjesëmarrës pas licencimit në qytetin e tyre do të kenë Mentorin, një nga gjyqtarët me përvojë, që do të përcjell punën dhe avancimin e tyre. Ky grup i gjyqtarëve fillestarë hynë në gjeneratën që kanë potencial shumë të madh, pasi që të gjithë janë ish- ose ende janë lojtarë aktivë të basketbollit

Mbahet FIBA SCOD Webinar Online dhe Fitnes testi për gjyqtarët

Në fundjavën (20 e 21 shtator) që kemi lënë pas është mbajtur FIBA SCOD Referees Webinar Online për gjyqtarët e FBK-së në platformën Zoom.

Në këtë webinar pjesëmarrës kanë qenë 57-60 gjyqtarë vëzhgues të FBK-së. Webinarin është udhëhequr nga FIBA Instruktori Nacional, FIBA Referee Instruktori Gjorgji Piperkov, Prof. Ridvan Ekmekci, si dhe me një fjalë përhëndetëse të gjithë gjyqtarëve i është drejtuar edhe FIBA Referee Manager, Davorin Nakiq, i cili falënderoi Federatën e Basketbollit të Kosovës për punën shumë të mirë për edukimin dhe avancimin e gjyqtarëve, duke mos anashkuar edhe punën gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, si dhe pjesëmarrjen e madhe të gjyqtarëve në webinarët e FIBA-s.

Vendimet kryesore të Bordit të FBK-së

Vendimet e Bordit të FBK-së të datës 30 korrik

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në mbledhjen e mbajtur më 30.07.2020 ka shqyrtuar situatën aktuale në basketbollin kosovar, rrethanat e krijuara nga pandemia globale dhe gjendjen e anëtarëve të vet, dhe ndër të tjera, ka vendosur unanimisht, si në vijim:

1. Ka emëruar Komesar të Garave të FBK-së, z. Faton Kurshumlija me mandat njëvjeçar, konform Statutit të FBK-së;
2. Ka miratuar në parim Draft-Propozicionet e Garave për edicionin e ri 2020/21 (kategorinë seniore), kalendarin e garave të Superligës së Kosovës dhe organizimin e garës përgatitore për edicionin e ardhshëm për ekipet e kategorive më të larta seniore në formë të turneut në disa qendra të Kosovës. Të njëjtat materiale do tu dërgohen të gjitha klubeve seniore që bëjnë gara në kuadër të FBK-së për komente dhe do të rikthehen sërish tek Bordi i FBK-së për miratimin përfundimtar brenda afatit statutor dhe rregullativ;
3. E ka miratuar raportin financiar për periudhën Janar – Korrik 2020;
4. Ka marrë vendim që të gjitha obligimet aktuale të klubeve ndaj FBK-së t'i "ngrijë" deri në datën e regjistrimit të tyre licencimit për edicionin 2021-22; Ka marrë vendim që të gjitha obligimet aktuale të klubeve ndaj FBK-së t'i "ngrijë" deri në datën e regjistrimit të tyre licencimit për edicionin 2021-22;
5. Ka emëruar Fidan Shatrin, trajnerin e KBF Prishtina dhe ish-përzgjedhësin e Kosova U16 dhe Kosova U20, si përzgjedhës të Përfaqësueses A të Kosovës - Femrat, ndërsa ka autorizuar Drejtorin e Përfaqësueseve, Kryetarin e FBK-së dhe Sekretaren e Përgjithshme për të koordinuar me Përzgjedhësin Shatri anëtarët e tjerë të shtabit teknik, të cilët Bordi i FBK-së do t'i emërojë në mbledhjet e radhës;
6. Ka marrë vendim që të shtyjë grumbullimet e Përfaqësueseve A të Kosovës (Meshkuj/Femra) që ishin paraparë gjatë muajit gusht 2020 për shkak të zhvillimeve të fundit me pandeminë COVID-19 në vendin tonë dhe ka autorizuar Drejtorin e Përfaqësueseve që në koordinim me Sekretaren e Përgjithshme të ri-planifikojë dhe vendosë për grumbullime të mëvonshme në bazë të situatës dhe udhëzimeve nga autoritetet dhe institucionet përgjegjëse;
7. Ka shqyrtuar kërkesat e KB Feronikeli dhe KB Lipjani, dhe ka rikonfirmuar vendimin e Bordit të FBK-së të datës 19 maj 2020 për plasman dhe rangim në stinorin 2020-21.

Vendimet e Bordit të FBK-së të datës 21 gusht

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) më 21.08.2020 ka marrë këto vendime:

1. Konform Nenit 45 të Rregullores së Përfaqësueseve të Kosovës, me propozim të Sekretares së Përgjithshme të FBK-së, Bordi i FBK-së e ka emëruar Kimete Halitin në cilësinë e Udhëheqëses së Delegacionit të Përfaqësueses A të Kosovës në konkurrencën e femrave për FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla që do të organizohet në vitin 2021 në Nicosia të Qipros.

2. Konform Nenit 41 të Rregullores së Përfaqësueseve të Kosovës me propozim të Drejtorit të Përfaqësueseve të Kosovës, Bordit i FBK-së ka emëruar këta trajnerë për postin e ndihmëstrajnerëve në Përfaqësuesen A të Femrave: Kemajl Muja, Pal Syla dhe Lorik Kllokoqi.

3. Konform Statutit të FBK-së dhe Rregullores për Organizimin e Brendshëm të FBK-së me propozim të Sekretares së Përgjithshme, Bordi i FBK-së e ka emëruar Leart Hoxhën personin përgjegjës nga Bordi i FBK-së për menaxher/koordinator të lojës së basketbollit 3x3 në kuadër të FBK-së. Përshkrimi i detyrave të tij do të bëhet konform Rregullores për Organizimin e Brendshëm të FBK-së nga Sekretarja e Përgjithshme.

Vendim i Bordit të FBK-së për shtyrjen e fillimit të edicionit të ri

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) duke i parë zhvillimet e fundit me pandeminë COVID-19, në bazë të kompetencave të veta statutare, sot (24 gusht) unanimisht ka marrë vendim që të shtyjë fillimin e edicionit të ri në basketboll 2020/21. Edicioni i ri në basketboll ka qenë i programuar të fillojë më 16.09.2020 me ndeshjet e Superkupës së Kosovës në të dyja konkurrencat dhe më pas të vazhdojë me garat e edicionit 2020-2021. Bordi i FBK-së ka marrë vendim që të shtyjë fillimin e edicionit të ri për një muaj, më saktësisht që edicioni i ri të fillojë më 14.10.2020, kur edhe do të organizohen ndeshjet e Superkupës së Kosovës. Ndeshjet e play-outit gjithashtu do të shtyhen për një muaj. Ky vendim është marrë duke parë gjendjen momentale të pandemisë COVID-19 në vendin tonë, por edhe pas konsultimeve me autoritetet përkatëse në nivel vendor dhe në pajtim me udhëzimet e profesionistëve shëndetësorë duke pasur në vëmendje dhe radhë të parë shëndetin e lojtarëve, trajnerëve, punëtorëve sportivë dhe të gjithë akterëve të përfshirë në organizimin e garave të basketbollit, si dhe karakteristikat e sportit tonë. Federata e Basketbollit të Kosovës e ka përgatitur Udhëzuesin për Rikthimin në Fushat e Basketbollit (versionin 3.0) dhe në momentin që Qeveria e Republikës së Kosovës merr vendim për lejimin e zhvillimit të stërvitjeve (dhe më pas edhe garave), atëherë FBK do t'i pajisë të gjithë anëtarët e saj me këtë Udhëzues, i cili do të jetë udhërrëfyes për ruajtjen e shëndetit të të gjithë basketbollistëve/eve, zyrtarëve të ekipit, zyrtarëve të ndeshjeve dhe gjithë komunitetit të basketbollit në vendin tonë. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 28 shtator

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) më 28.09.2020 ka marrë vendim për shtyrjen e fillimit të edicionit të ri të garave në mënyrë që t'ju jap kohë të mjaftueshme skuadrave të saj për tu përgatitur sa më mirë për edicionin e ri.

Në këtë mënyrë:

- Ndeshjet e play-outit do të zhvillohen më 14 dhe 17 Tetor 2020;
- Turneu i Superkupës së Kosovës do të zhvillohet prej 21 deri më 25 Tetor;
- Edicioni i ri në Superligën e Kosovës do të fillojë më 28/29 Tetor;
- Afati kalimtar për basketbollistë/e shtyhet deri më 5 Tetor në ora 16:00.

Vendimet e Bordit të FBK-së i datës 30 shtator

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2020 ka shqyrtuar situatën aktuale në basketbollin kosovar, rrethanat e krijuara nga pandemia globale dhe gjendjen e anëtarëve të vet, dhe ndër të tjera, ka vendosur unanimisht, si në vijim:

- I ka miratuar Propozicionet e Garave të Kategorive të Reja dhe kalendarët e garave të kategorive të reja për edicionin 2020/21;

- E ka miratuar Rregulloren për Kalim dhe Regjistrim për edicionin 2020/21;
- E ka miratuar raportin e punës dhe atë financiar për muajin shtator;
- E ka miratuar listën e gjyqtarëve, vëzhguesve dhe kontrollorëve të FBK-së për Ligën UNIKE;
- E ka shqyrtuar kërkesën e KB Feronikeli për paraqitje për gara pas përfundimit të afatit kalimtar dhe ka vendosur që të lejojë regjistrimin e këtij ekipi në Ligën e Dytë të Meshkujve për edicionin 2020/21;
- Ka marrë vendim që të shpall Wild Card për pjesëmarrje të një skuadre nga Liga e Dytë e Meshkujve për në Ligën e Parë të Meshkujve për edicionin 2020/21;
- E ka emëruar Grupin e Punës për përgatitjen e Rregullores për Licencimin e Klubeve për edicionin 2021/22 në përbërje prej: Elvira Dushku-Sekretare e Përgjithshme, Linda Shala-Anëtare e Bordit dhe Leart Hoxha -Anëtar i Bordit;
- Me shqetësim të madh e ka pranuar informatën dhe raportin nga Klinika e Trajnerëve e mbajtur në fundjavën që e lamë pas, ku një pjesë e konsiderueshme e trajnerëve të SHTBK-së nuk e kanë përcjellur Klinikën, e cila është një nga kriteret kryesore për licencim të trajnerëve për edicionin 2020/21. Andaj Bordi i FBK-së ka kërkuar nga SHTBK që trajnerëve që kanë munguar në këtë Klinikë tu jap edhe një rast për të dëgjuar ligjeratat online dhe në të njëjtën kohë ka kërkuar nga këta trajnerë të paguajnë shumën 60 Euro për pjesëmarrje në këtë Klinikë. Të hollat duhet të transferohen në xhirollogarinë e SHTBK-së para fillimit të Klinikës.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



TEB



RUGOVE®

